



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1050/ 12 prot.

Datë 28/05/2024

V E N D I M
Nr. 581/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28/05/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 482/2024, datë 10.05.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur -Shërbime”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softëare-ve”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “KREATX” SHPK me Nipt L12121023B me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga “Tish Daija” Kompleksi “Kika 2”, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A
Adresa: *Adresa: L.17 Rr.Dalip Peza, Durrës.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 482/2024, datë 10.05.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KREATX” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur -Shërbime”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softëare-ve”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “KREATX” ShPK, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KREATX” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 197/58 prot., datë 16.05.2024, protokolluar me tonën nr. 1050/9 prot., datë 20.05.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 482/2024, datë 10.05.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar operatorin ekonomik “KREATX” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur -Shërbime”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softëare-ve”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 197/58 prot., datë 16.05.2024, protokolluar me tonën nr. 1050/9 prot., datë 20.05.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A, lidhur

me zbatimin e Vendimit Nr. 482/2024, datë 10.05.2024, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e kualifikuar operatorin ekonomik “KREATX” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur -Shërbime”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softëare-ve”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën e prokurimit, duke kualifikuar operatorin ekonomik “KREATX” Sh.P.K në procedurën e mësipërme të prokurimit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 482/2024, datë 10.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur -Shërbime”, me Nr. REF-98882-03-20-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softëare-ve”, me fond limit 13.965.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
KreshnikTernova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri